



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1002 prot.

Tiranë, më 07.07.2022

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave për të garantuar përfitimin në mënyrë efektive të ndihmës ekonomike, nga ana e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare.

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Rruga e Kavajës

Tiranë

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

Rruga e Durrësit, nr.83

Tiranë

BASHKISË TIRANË

Sheshi Skënderbej, Nd.2

Tiranë

BASHKISË KAMËZ

Bulevardi “Nënë Tereza”

Kamëz

KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Rruga “Ana Komnena”, Godina “Poli i Drejtësisë”

Tiranë

Për dijeni: **KOMISIONIT PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË**
KUVENDI I SHQIPËRISË
Tiranë

**NËNKOMISIONIT PËR BARAZINË GJINORE DHE
PARANDALIMIN E DHUNËS NDAJ GRUAS
KUVENDI I SHQIPËRISË
Tiranë**

KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë

QENDRËS “TË DREJTAT E NJERIUT NË DEMOKRACI”
Rruga “Panorama”, Kompleksi Pajtoni, Ap.B 31 (pranë Hipotekës)
Tiranë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (*në vijim Komisioneri*), është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar (*në vijim LMD*), si institucion i pavarur, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin.

Në nenin 32, pika 1, germa “c”, të LMD, përcaktohet se: “*Komisioneri ka kompetencë të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji*”.

Bazuar në informacionin e marrë nga Qendra “Të drejtat e Njeriut në Demokraci” (*në vijim QDNJD*) Komisioneri, në ushtrim të kompetencës së parashikuar nga neni 32/1/c të LMD, me urdhërin nr. 149 datë 08.10.2021, filloi procedurat për ndjekjen kryesisht të çështjes mbi praktikën që ndiqet lidhur me përfitimin e ndihmës ekonomike nga viktimat e dhunës në familje, pas pajisjes me urdhër mbrojtje (UM) dhe urdhër të menjëhershëm mbrojtje (UMM).

I. Informacioni i parashtruar nga QDNJD

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, QDNJD si një organizatë që ofron shërbime mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familje, ka konstatuar problematika sa i përket ofrimit të ndihmës ekonomike nga viktimat/të mbijetuarat e dhunës në familjes pas pajisjes me UM dhe UMB. Në lidhje me problematikën e konstatuar, organizata, shpjegon se, pavarësisht se legjislacioni në fuqi parashikon të drejtën e viktimave/të mbijetuarave të dhunës në familje për përfitimin e ndihmës ekonomike që nga momenti i pajisjes me UMM/UM, njësitë e vetëqeverisjes vendore mundësojnë ofrimin e kësaj ndihme vetëm për rastet që janë pajisur me UM me afat mbi 1-muaj dhe kur vendimi ka marrë formë të prerë, duke përjashtuar në këtë mënyrë rastet e pajisura me UMB.

Sipas nenit 19/6, të ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar, zyrat e shërbimeve sociale të njësive së vetëqeverisjes vendore kanë detyrimin që të ofrojnë shërbime (përfshirë ndihmën ekonomike) për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare që nga moment i lëshimit të UMM. Megjithëse viktimat/të mbijetuarat nga dhuna kanë ligjërisht të drejtë të përfitojnë ndihmë ekonomike, përgjatë afatit të vlefshmërisë së urdhërit të mbrojtjes, në praktikë ndodh që viktimat e përfiton këtë ndihmë vetëm për periudhën e mbetur që nga moment i paraqitjes pranë zyrës përkatëse të ndihmës ekonomike.

Sipas QDNJD, një problematikë tjetër që vështirëson aksesin e viktimave të dhunës në familje në përfitimin e ndihmës ekonomike, ka të bëjë me ankimimin e vendimit të lëshimit të urdhërit të mbrojtjes. Megjithëse sipas nenit 21 të ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar, Gjykata e Apelit duhet të shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit, kjo organizatë ka konstatuar se shqyrtimi i ankimeve nga Gjykata e Apelit për këto çështje ka vonesa disa mujore. Kjo sjell si pasojë mospërfitimin e ndihmës ekonomike nga viktimat deri në momentin që vendimi të marrë formë të prerë dhe humbje të së drejtës për të përfituar ndihmën ekonomike përgjatë muajve që çështja ka qënë në proces në Gjykatën e Apelit. QDNJD, shprehet se, në praktikën e saj ka konstatuar mjaft raste ku viktimat e dhunës në familje e humb pjesën më të madhe të ndihmës ekonomike, pasi çështja është ankimuar dhe vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Këto vonesa zgjasin për periudha disa mujore.

Megjithëse sipas nenit 21/2 ligjit nr.9669 datë 18.12.2006 “*Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar parashikohet se: “*Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose të urdhrit të mbrojtjes*”, praktika që ndiqet nga organet e vetëqeverisjes vendore është e tillë që viktimave të dhunës në familje ju kërkohet në çdo rast vendimi formës së prerë për përfitimin e ndihmës ekonomike.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri.

A. Me shkresën nr.1418/1 prot., datë 16.11.2021, Komisioneri njoftoi për fillimin e procedurave të hetimit të çështjes, Shërbimin Social Shtetëror (*në vijim SHSSH*) dhe kërkoi nga ky i fundit informacion në lidhje me problematikat objekt shqyrtimi. Me shkresën sipërcituar, Komisioneri njoftoi për fillimin e procedurave të shqyrtimit të kësaj çështje edhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (*në vijim MSHMS*).

A.1 Me shkresën nr.2127/1 prot., datë 22.11.2021, SHSSH, ktheu përgjigje duke informuar Komisionerin, si më poshtë parashtrohet:

Në ligji nr.57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, gërma “d” dhe VKM nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Kreu I, pika 2, gërma “d”, përcaktohet se përfituesit e ndihmës ekonomike janë :.....(d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore”.

Për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike, në Kreun I, pika 4.5, të VKM së sipërcituar përcaktohet se, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes paraqesin: (a) kopjen e kartës së identitetit, (b) urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes.

Për sa më sipër, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare që rezultojnë të pajisura me urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtje, kanë të drejtë të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore në bashkitë/njësitë vendore nga data 1-10 të çdo muaji, për të përfituar ndihmë ekonomike dhe dokumentat e përcaktuara më sipër (karta e identitetit dhe UM ose UMM të lëshuar nga gjykata) dhe pa qenë të detyruar për t’u pajisur me një vendim gjyqësor të formës së prerë. Nisur nga fakti se sistemi i ndihmës ekonomike qëndron i hapur për aplikim nga data 1-10 të çdo muaji, për të gjitha ato raste kur UM ose UMM lëshohet pas datës 10 të çdo muaji, qytetarëve u jepet e drejta për të aplikuar në muajin pasardhës dhe e drejta e përfitimit shtrihet nga muaji i aplikimit përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së UM ose UMM, pa humbur përfitimin e muajit përkatës të cilin është lëshuar UM apo UMM nga gjykata.

SHSSH, informon se pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH nuk kanë ardhur ankesa nga qytetarët lidhur me këtë problematikë.

Lidhur me pagesat për muajt paraardhës, në rast ankimi të vendimit apo paraqitjes pas një kohe të caktuar të qytetarëve për të aplikuar, SHSSH informon se, nuk ka asnjë parashikim ligjor sipas legjislacionit në fuqi. Nisur nga fakti se ligji nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, i njeh të dretën çdo viktime të dhunës në marrëdhëniet familjare të aplikojnë për ndihmë ekonomike në momentin që rezultojnë të pajisur me urdhër mbrojtje ose urdhër të menjëhershëm mbrojtje, nuk parashikohen lehtësira ligjore lidhur me përfitimin për muajt paraardhës.

SHSSH thekson se, ai është një institucion ekzekutiv, si dhe monitoron dhe kontrollon zbatimin e legjislacionit në fuqi.

A.2 Në datë 02.12.2021, QDNJD, paraqiti nëpërmjet postës elektronike (me email) parashtrimet e saj, si më poshtë:

Pavarësisht se legjislacioni në fuqi parashikon të drejtën e viktimave/të mbijetuarve të dhunës në familje për përfitimin e ndihmës ekonomike që nga momenti i pajisjes me UMB/UM, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore mundësojnë ofrimin e kësaj ndihme vetëm për rastet që janë pajisur me UM me afat mbi 1-muaj dhe në rastet kur vendimi ka marrë formë të prerë, duke përjashtuar në këtë mënyrë rastet e pajisura me UMM përgjatë afatit të vlefshmërisë së këtij urdhëri, si dhe duke i përjashtuar për disa muaj, deri në marrjen formë të prerë të vendimit për lëshimin e UM.

QDNJD, parashtron se këto problematika, i mbështet në disa prej rasteve të trajtuara nga ana e saj, të cilat kanë mundur të përfitojnë ndihmën ekonomike vetëm pasi vendimi ka marrë formë të prerë. QDNJD, vendosi në dispozicion të Komisionerit, informacion mbi procedurat e ndjekura për përfitimin e ndihmës ekonomike, për disa raste konkrete të viktimave të dhunës në familje.

B. Bazuar në informacionin e vendosur në dispozicion, Komisioneri konstatoi se praktikat e përfitimit të ndihmës ekonomike nga ana e viktimave të dhunës në familje të përcjella nga QDNJD, i takonin disa njësi administrative në Bashkinë Tiranë¹ dhe Bashkinë Kamëz².

B.1 Me shkresën nr.93/1 prot datë 12.01.2022, Komisioneri i'u drejtua Bashkisë Tiranë, duke e njoftuar për procedurat e shqyrtimit të kësaj çështje, si dhe duke kërkuar informacionin në lidhje me problematikën objekt shqyrtimi. Me shkresën nr.1813/1 prot., datë 24.01.2022, Bashkia Tiranë ktheu përgjigje, duke informuar Komisionerin si më poshtë:

Në zbatim të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “*Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*”, i ndryshuar, VKM nr.327/2021 “*Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës*”, Bashkia Tiranë koordinon veprimtarinë e Mekanizmit të Referimit që funksionon prej vitesh në territorin e saj, duke luajtur një rol thelbësor në adresimin me efektivitet të rasteve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, duke siguruar mbrojtje, informim, ndihmë ekonomike, strehim social, ndërmjetësim për punësim, këshillim psikologjik dhe ligjor; këshillim për djem dhe burra

¹Në Bashkinë Tiranë:

Znj. X.X, banuese në Njësinë Administrative Nr.4;
Znj. X.X, banuese në Njësinë Administrative Nr.4;
Znj. X.X, banuese në Njësinë Administrative Nr.3;
Znj. X.X, banuese në Njësinë Administrative Zall Herr;
Znj. X.X, banuese në Njësinë Administrative Zall Herr;

² Në Bashkinë Kamëz:

Znj. X.X, banuese në Bashkinë Kamëz;
Znj. X.X, banuese në Bashkinë Kamëz;
Znj. X.X, banuese në Bashkinë Kamëz;
Znj. X.X, banuese në Bashkinë Kamëz;
Znj. X.X, banuese në Njësinë Administrative Paskuqan;

dhunues; aktivitete ndërgjegjësuere dhe informuese të komunitetit; koordinim me të gjithë aktorët e mekanizmit, përfshirë Qendrën “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”.

Gjithashtu, në zbatim të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 7, pika d, theksohet se, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare janë përfitues të ndihmës ekonomike, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Procedura e ndihmës ekonomike, mbi të cilat administratori shoqëror pranë njësive të vetëqeverisjes vendore vepron, bazohet tek VKM nr.597, datë 04.09.2019. Sipas kreut II, pika 1 *“administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit.”*

Sipas Kreut II, pikës 9, të VKM-së nr.597, datë 04.09.2019, është Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, institucioni përgjegjës për realizimin e procesit të vendimarrjes brenda muajit të aplikimit të qytetarëve për ndihmë ekonomike dhe si pasojë pagesa merret duke filluar nga muaji në të cilin kryhet aplikimi dhe jo për muajt e prapambetur, edhe pse në regjistrin elektronik të ndihmës ekonomike është hedhur nga administratori shoqëror afati i vlefshmërisë të përfitimit të urdhrit të mbrojtjes.

Problematika e referuar nga administratorët shoqërorë është vonesa në marrjen e vendimit të UM në formë të prerë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke penguar aplikimin e skemës së ndihmës ekonomike dhe më pas përfitimin e pagesës sipas afatit të vlefshmërisë.

Bashkia Tiranë bën me dije se, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale pranë kësaj bashkie, nuk ka asnjë rol në procesin e vendimarrjes dhe gjenerimin e ndihmës ekonomike, por është Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, e cila kryen procesin e vendimarrjes dhe gjenerimin e ndihmës ekonomike, në bazë të deklarimeve të familjeve në nevojë dhe kategorive të veçanta të hedhura në sistem nga administratori shoqëror. Bashkia Tiranë sugjeron që, problematika e parashtruar duhet drejtuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Në mbledhjet e Mekanizmit të Referimit është referuar dhe diskutuar problematika e sipërpërmendur dhe është lehtësuar procesi i aplikimit në skemën e ndihmës ekonomike, rast pas rasti nga Koordinatori Vendor kundër Dhunës në Familje, në bashkëpunim me institucionet e linjës, veçanërisht me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe administratorët shoqërorë në Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë.

Bashkia Tiranë paraqiti informacion në lidhje me praktikat e kërkuara, por nuk depozitoi kopje të dokumentacionit shoqërues për secilën nga praktikat e kërkuara.

B.2 Me shkresën nr.93 prot datë 12.01.2022, Komisioneri i'u drejtua Bashkisë Kamëz, duke e njoftuar për procedurat e shqyrtimit të kësaj çështje, si dhe duke kërkuar informacionin në lidhje me problematikat objekt shqyrtimi. Me shkresën nr.255/1 prot., datë 26.01.2022, Bashkia Kamëz ktheu përgjigje, duke informuar Komisionerin, si më poshtë:

Në shtator të vitit 2020 në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale është ngritur sektori i mbrojtjes së fëmijëve dhe barazisë gjinore, pjesë e së cilës janë specialistët e mbrojtjes së fëmijëve dhe barazisë gjinore, si dhe koordinatori vendor kundër dhunës në marrëdhëniet familjare. Ky sektor funksionon specifikisht sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm nr.18/2017 *“Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*, ligjit nr.9669/2006 *“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar, sikundër dhe VKM-së nr. 327, datë 02.06.2021 *“Për Mekanizmin e Bashkëpunimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe procedimit të tij për mbështetjen e rehabilitimit të viktimave të dhunës në familje”* kur bëhet fjalë për rastet të viktimave të dhunës në familje, por në mënyrë absolute pa u kufizuar në to.

Në kuadër të Mekanizmit të referimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, koordinatori vendor kundër dhunës në Bashkinë Kamëz, në bashkëpunim me specialistë të barazisë gjinore të emëruar në njësi/lagje administrative, kanë trajtuar dhe menaxhuar rastet e dhunës në familje, duke ofruar shërbimet sipas dinamikave dhe rrezikshmërisë që rastet kanë shfaqur.

Kështu, kur vendimet e UMM/UM dërgohen nga gjykata drejt bashkisë, koordinatori vendor i dërgon vendimet menaxherit të rastit, në zonën ku viktimat e dhunës në familje është banor, duke mundësuar një kontroll ndaj njoftimeve të viktimës, për ofrimin dhe marrjen e shërbimeve sipas specifikës së rastit. Shporta e shërbimeve, përveç pagesës mujore si viktimitë e dhunës në familje sipas përcaktimit të pikës (d) të nenit 7, të ligjit nr.57/2019 *“Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”* përfshin edhe shërbime të tilla si: konsulencë ligjore/përfaqësim në gjykatë, mbështetje psikosociale, orientim për aplikim në programin e strehimit, mbështetje dhe orientim në shërbimet shëndetësore, mbështetje dhe orientim në programet e punësimit apo kurseve profesionale, mbështetje dhe orientim në programet arsimore për fëmijët e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, mbështetje me mjete transporti për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare drejt shërbimeve apo institucioneve që iu nevojitet të paraqiten, mbështetje me ndihmë ekonomike nga fondi lokal për një periudhë të kufizuar kohe, etj.

Bashkia thekson se, nuk është kufizuar vetëm në dhënien e shërbimeve sociale apo të orientimit në sistemin elektronik të ndihmës ekonomike, por duke vlerësuar rastet në specifikat e tyre, ka ndjekur dhe metodën e referimit nga sektori i mbrojtjes së fëmijëve dhe

barazisë gjinore, drejt sektorit të ndihmës ekonomike dhe PAK, për të propozuar në Këshill Bashkiak, emra të familjeve në nevojë, për t'u ndihmuar nga fondi lokal. Kjo është bërë me qëllim për të ndihmuar mbulimin e muajve të papaguar nga sistemi i ndihmës ekonomike, pasi efekti financiar fillon nga momenti i aplikimit deri në momentin e përfundimit të vlefshmërisë të caktuar në vendimin e gjykatës.

Në lidhje me trajtimin e kësaj problematike në Mekanizmin e Referimit pranë Bashkisë Kamëz, kjo e fundit informon se, janë evidentuar disa raste sporadike. Këto të fundit janë evidentuar në mbledhjet e MKR-së, ku në interpretim të aktorëve prezent është theksuar fakti i fillimit të efektit financiar sipas përcaktimeve të akteve ligjore në fuqi.

Bashkia Kamëz thekson se, Sektori i Mbrojtjes së Fëmijës dhe Barazisë Gjinore ka mundësuar objektivin e aplikimeve në sistemin elektronik brenda afateve ligjore të përcaktuara, megjithatë paraqitja e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare brenda afateve (1-10 të çdo muaji) është zgjidhje e lidhur ngushtësisht me personin, i cili është i pajisur me UMM/UM.

Bashkia Kamëz, paraqiti informacion në lidhje me praktikën e kërkuara, por nuk depozitoi kopje të dokumentacionit shoqërues për secilën nga praktikat e kërkuara.

C. Bazuar në nenin 33, pika 8, të LMD, ku parashikohet se: *“8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”*, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri në datën 23.02.2022, zhvilloi një seancë dëgjimore publike, me pjesëmarrjen e :

- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), përfaqësuar nga znj. B.D, Përgjegjëse, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shtetit dhe Mbrojtjes Sociale, në MSHMS, sipas autorizimit nr.654/1 prot., datë 16.02.2022.
- Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), përfaqësuar nga znj. D.M, Specialiste pranë Drejtorisë së Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, sipas autorizimit nr. 320/1 prot., datë 22.02.2022.
- Bashkisë Tiranë, përfaqësuar nga: znj. A.B, Koordinatore Vendore kundër dhunës në familje; znj. M.L, Specialiste në Drejtorinë e Kujdesit Social dhe Shërbimeve të Integruara; znj. L.B, Administratore Shoqërore, Njësia Administrative nr.1, znj. D.B, Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve, Njësia Administrative nr.3; znj. N.M, Administratore Shoqërore, Njësia Administrative nr.4; znj. D.H, Administratore Shoqërore, Njësia Administrative Zall-Herr, sipas autorizimit të dërguar me e-mailin e datës 15.02.2022.
- Bashkisë Kamëz, përfaqësuar nga: znj. A.Gj, Koordinatore vendore kundër dhunës në familje, znj. A.D, Përgjegjëse e ndihmës ekonomike dhe PAK, znj. A.P, Përgjegjëse e

ndihmës ekonomike dhe PAK, Njësia Administrative Bathore, sipas autorizimit të dërguar me e-mailin e datës 22.02.2022.

- Qendrës “Për të Drejtat e Njeriut në Demokraci”, përfaqësuar nga znj. O.A dhe znj. L.C, sipas autorizimit të datës 22.02.2022.

Gjatë seancës u diskutua në lidhje me praktikën e ndjekur nga Bashkia Tiranë dhe Bashkia Kamëz, në lidhje me procedurat përfitimin e ndihmës nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në raport me çështjet objekt shqyrtimi, si dhe qasjen e SHSSH në lidhje me këto çështje. Gjatë seancës u administruan praktikrat e rasteve nga Bashkia Tiranë.

Gjatë seancës dëgjimore QDNJD, theksuan nevojën dhe kërkuan që nga ana e SHSSH të nxirrej një udhëzim për të gjithë administratorët shoqërorë me qëllim shmangien e keqinterpretimeve dhe krijimin e praktikave të njëjta nga të gjithë administratorët shoqërorë. Përfaqësuesit e Bashkisë Kamëz dhe Bashkisë Tiranë, gjithashtu theksuan nevojën që ata të sqaroheshin dhe të udhëzoheshin zyrtarisht në lidhje me këto çështje.

- D. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr.1123/1 prot., datë 23.02.2022, Bashkia Kamëz, vendosi në dispozicion të Komisionerit praktikrat e rasteve respektive.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.
2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.
3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 14

Ndalimi i diskriminimit

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo

mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Protokolli 12, i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1

Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.
2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (në vijim Konventa e Stambollit)³

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllim të kësaj Konvente:

- a “dhunë kundër grave” kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi kundër grave dhe nënkupton të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private;
- b “dhunë në familje” nënkupton të gjitha aktet e dhunës fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse autori i veprës penale ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën;
- e “viktimë” nënkupton çdo person fizik që i nënshtrohet sjelljes së përcaktuar në pikat a dhe b;

Neni 4

Të drejtat themelore, barazia dhe mosdiskriminimi

3 Zbatimi i dispozitave të kësaj Konvente nga Palët, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë

³ Ratifikuar me ligjin nr. 104/2012, datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”

kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

Neni 20

Shërbimet e përgjithshme mbështetëse

1 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime që lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna. Këto masa duhet të përfshijnë, sipas nevojës, shërbime të tilla si konsulenca ligjore dhe psikologjike, ndihma financiare, strehimi, arsimi, trajnimi dhe ndihma në gjetjen e një pune.

2 Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime sociale dhe në kujdes shëndetësor, dhe që shërbimet të kenë burime të mjaftueshme dhe profesionistët të jenë trajnuar për të ndihmuar viktimat dhe për t'i drejtuar ata tek shërbimet përkatëse.

Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (në vijim LMD)

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Neni 3

Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.

7. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga 3 një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

Neni 5

Ndalimi i diskriminimit

1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7

Mbrojtja nga diskriminimi

1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim.

2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Neni 20

Të mirat dhe shërbimet

1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.

2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:

c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun;

Neni 22

Statusi

Komisioneri është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe u nënshtrohet vetëm Kushtetutës dhe ligjit.

Neni 32

Kompetencat

1. Komisioneri ka kompetencë:

c) të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;

ë) t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

f) të publikojë raporte dhe të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;

Ligji nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar (në vijim ligji nr.9669/2006)⁴

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në dispozita të veçanta të tij, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. “Dhunë” është çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një personi tjetër, që sjell si pasojë cenim të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social, ekonomik.

2. “Dhunë në familje” është çdo akt dhune, sipas pikës 1 të këtij neni, i ushtruar midis personave që janë apo kanë qenë në marrëdhënie familjare.

.....

⁴ Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008; nr. 10 329, datë 30.9.2010; nr. 47/2018, datë 23.7.2018; nr. 125/2020, datë 15.10.2020.

4. “Viktimë” është personi mbi të cilin është ushtruar dhuna e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

.....

6. “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar me vendim gjykate, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën.

7. “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht me vendim gjykate, i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate.

Neni 17

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes

.....

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, i cili, përveçse përmbush kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 12 muaj, por me të drejtë shtyrjeje;

c) njoftimin se shkelja e urdhrit të mbrojtjes, të lëshuar me vendim gjykate, përbën vepër penale në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) njoftimin për të drejtën e ankimit ndaj urdhrit të mbrojtjes.

.....

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) prokurorit, nëse ka bërë kërkesë;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njërive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

.....

Neni 19

Vendimi i gjykatës për lëshimin e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes

.....

3. Vendimi përfundimtar i gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, i cili duhet të plotësojë kërkesat e nenit 310 të Kodit të Procedurës Civile, përmban:

a) masën e caktuar nga gjykata;

b) kohëzgjatjen e masës, e cila mbaron në momentin që fillon të zbatohet urdhri i mbrojtjes i vendosur nga gjykata;

c) njoftimin se shkelja e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën vepër penale, në kuptim të nenit 320 të Kodit Penal;

ç) Shfuqizuar;

d) datën e dëgjimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, e cila është brenda 20 ditëve prej lëshimit të tij me vendim gjykate.

.....

5. Gjykata, brenda 24 orëve pas lëshimit të vendimit, u dërgon nga një kopje të tij personave në vijim:

a) viktimës dhe personave të tjerë të shënuar në vendim;

b) kërkuesve në kuptim të nenit 13 të këtij ligji;

c) zyrës së shërbimeve sociale të njësive vendore, ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim;

ç) komisarit të policisë në rajonin ku janë me banim të përhershëm apo të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

d) zyrave përmbartimore të vendit të ekzekutimit.

6. Vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësive të vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë, të parashikuar në vendim.”.

Neni 20

Gjykimi për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes

Gjykata kryen seancën, sipas nenit 16, të këtij ligji, jo më vonë se 20 ditë, nga dita e lëshimit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes. Në përfundim të procesit gjyqësor, gjykata:

a) vendos anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate, kur ky i fundit nuk arrin të provohet;

b) refuzon lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykate;

c) lëshon urdhrin e mbrojtjes me vendim gjykate në bazë të nenit 17 të këtij ligji. Sipas nevojës, ky vendim mund t'i ndryshojë kushtet e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykate

Neni 21

Ankimi

1. Kundër vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes, vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, si dhe moslëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar. Gjykata e apelit shprehet me vendim brenda 15 ditëve nga dita e regjistrimit të ankimit. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë. Kundër vendimit të

gjykatës që ka lëshuar urdhrin e mbrojtjes nuk lejohet ankimi nga viktimat, përveç rastit kur viktimat pretendon se masat e vendosura nuk garantojnë mbrojtje.

2. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes ose të urdhrin të mbrojtjes.

Neni 23

Ekzekutimi i vendimit gjyqësor

1. Vendimi gjyqësor për lëshimin e urdhrin të mbrojtjes është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv nga dita e shpalljes së tij. Së bashku me urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, gjykata lëshon edhe urdhrin e ekzekutimit të tij. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga strukturat e Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të përmendur në vendim.

2. Shfuqizuar.

3. Punonjësit socialë dhe efektivat e policisë marrin të gjitha masat për ekzekutimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të masave mbrojtëse të vendosura konform nenit 10 të këtij ligji.

3/1 Gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, zyra e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore monitoron respektimin e urdhrin të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit. Palët përkatëse në vendimin gjyqësor bashkëpunojnë për të siguruar vizitat në banesë të përfaqësuesve të zyrës së shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve përgjegjëse, sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm.

.....

Ligji Nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr.57/2019)

Neni 2

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;

b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre;

c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura;

ç) mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale

Neni 4

Përkufizime

k) “Ndihma ekonomike”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj;

r) “Regjistri elektronik kombëtar i ndihmës ekonomike”, është bashkësia e të dhënave të përfituara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të ndihmës ekonomike gjatë procesit të aplikimit të familjeve/individëve në nevojë për përfitim të ndihmës ekonomike;

xh) “Viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare”, është çdo person, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, për të cilin është lëshuar urdhër mbrojtjeje ose urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje me vendim të gjykatës;

Neni 5

Parime të përgjithshme

Parimet bazë, në bazë të të cilave funksionojnë programet e asistencës sociale janë:

d) mosdiskriminimi është parimi që përcakton të drejtat që burojnë nga ky ligj pa asnjë lloj diskriminimi çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër;

Neni 6

Asistenca sociale

Asistenca sociale përfshin, por nuk kufizohet në, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitime të tjera, që garantohen nga ky ligj.

Neni 7

Përfituesit e ndihmës ekonomike

Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;

- b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
- ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;
- d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Neni 12

Pagesa e ndihmës ekonomike

1. Ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji.

.....

7. Anëtarit të familjes në nevojë, që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuan dënimin me heqje lirie ose që trajtohet me mjekim të detyruar me vendim gjykate, në institucionet mjekësore të posaçme, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

8. Procedura, dokumentacioni dhe masa mujore e përfitimit të ndihmës ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Masa e ndihmës ekonomike, për familjet në nevojë, përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe shkon deri në 150 për qind e masës së pensionit social dhe e indeksuar.

Neni 16

Aplikimi dhe përfitimi i ndihmës ekonomike

1. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet nga:

- a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e;
- b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykate të formës së prerë;
- c) nga vetë individi, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “ç” e “d”, të nenit 7.

2. Aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së pikëzuar, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj nga bashkia nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vendimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

.....

Neni 19

Roli i ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale

Ministria përgjegjëse për Çështjet Sociale është autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të programeve dhe legjislacionit, programimin e fondeve për programet e asistencës sociale, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendore.

.....

Neni 20

Roli i Shërbimit Social Shtetëror

1. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, është institucion publik në varësi të Ministrisë përgjegjëse për Çështjet Sociale.

.....

2. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, përgjigjet për zbatimin e politikave të asistencës sociale të Ministrisë përgjegjëse për Çështjet sociale, si më poshtë:

.....

c) kontrollin dhe monitorimin e veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale, në kuptim të këtij ligji, në strukturat dhe institucionet në varësi të tij dhe pranë njësive të vetëqeverisjes vendore.

.....

4. Shërbimi Social Shtetëror në nivel rajonal, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike, ka këto përgjegjësi:

a) verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë në Regjistrin Kombëtar Elektronik dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse;

- b) merr vendim për caktimin e familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, masën e përfitimit të tyre si edhe refuzimin e kërkesës për dhënien e përfitimit të ndihmës ekonomike të shoqëruar me arsyet e refuzimit;
- c) i dërgon vendimin kryetarit të bashkisë:
 - i) për të njoftuar kërkesit për përfitimin e ndihmës ekonomike;
 - ii) për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës ekonomike.

Neni 22

Roli i strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki

Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, për efekt të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, kryen këto detyra:

.....

- d) monitoron punën e administratorit shoqëror, për të shmangur veprime të kryera nga ana e tij në kundërshtim me këtë ligj;

Neni 23

Roli i administratorit shoqëror të njësisë administrative

Administratorët shoqërorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë:

- a) të identifikojnë familjet dhe individët në nevojë dhe t'i ftojnë e t'i informojnë për aplikim për ndihmë ekonomike;
- b) të plotësojnë aplikimin për familjet dhe individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar;

.....

- ë) të ndërpresin pagesën e aftësisë së kufizuar për personat që përfitojnë në kundërshtim me germën a, të nenit 11, të këtij ligji, në bazë të verifikimit të kryer nga strukturat përgjegjëse të shërbimit social shtetëror në nivel rajonal;

.....

- i) të informojnë dhe të udhëzojnë komunitetet lidhur me skemën e ndihmës ekonomike dhe pagesën e aftësisë së kufizuar, me anë të fushatave të ndryshme informuese;

Vendim i Këshillit të Ministrave nr.597, datë 4.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” (në vijim VKM nr.597/2019)

Kreu I

Subjektet, Kriteret dhe Dokumentacioni për Përfitimin e Ndihmës Ekonomike

- 2. Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:

d) viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

4.5 Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, paraqesin:

a) kopjen e kartës së identitetit;

b) urdrin e mbrojtjes ose urdrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara në shkronjën “d”, të pikës 2, të këtij kreu;

Kreu II

Procedura e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike

1. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit të dhënat e mëposhtme:

.....

9. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror realizon procesin vendimarrjes brenda muajit të aplikimit të qytetarëve për ndihmë ekonomike.

Kreu III

Masa e ndihmës ekonomike

8. Masa e ndihmës ekonomike për çdo viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare që nuk trajtohet në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të përcaktuar në urdhërin e mbrojtjes apo urdrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë të urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të përcaktuar në vendimin e gjykatës .

Vendim nr. 868, datë 29.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” (në vijim VKM nr.868/2021)

1. Në kreun III, të vendimit nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikat 7, 8 dhe 9, fjalët “... 3 000 (tre mijë) lekë në muaj ...” zëvendësohen me “... 9 000 (nëntë mijë) lekë në muaj ...”

.....

2. Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2022.

Vendimi nr. 327, datë 2.06.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës” (në vijim VKM nr.327/2021)

I. Dispozita të Përgjithshme

.....

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Koordinator vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare”, punonjësi pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;
- b) “Menaxhim i rastit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave”, veprimtaria efektive që siguron ndihmën e mbështetjen e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare, me qëllim mbrojtjen, garantimin e të drejtave dhe rehabilitimin e tyre

II. Bashkërendimi i Institucioneve për Menaxhimin e Rasteve të Dhunës në Familje

1. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje krijohet pranë çdo bashkie dhe ka për qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje

2. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga:

- a) komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;
- b) ekipet teknike ndërdisiplinore (në vijim, ETN);
- c) koordinatorët vendorë (në vijim, KV).

6. Komiteti drejtues kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe ka në përbërje:

.....

ç) drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë;

d) përfaqësuesin e strukturës për shërbimet sociale në bashki ose qark;

.....

f) drejtuesit e organizatave jofitimprurëse, të cilat janë të specializuara dhe punojnë në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

.....

i) KV-në, i cili, për rastet kur bashkia ka 2 (dy) të tillë, caktohet nga kryetari i bashkisë.

.....

14. Komiteti drejtues, në veprimtarinë e tij:

a) ndjek zbatimin e detyrimeve dhe të politikave që burojnë nga ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, për organet e vetëqeverisjes vendore përfshirë, por pa u kufizuar në detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nevojat specifike të viktimave;

b) ndjek identifikimin e problemeve për dhunën në familje dhe zbatimin e ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare në territorin e të bashkisë/qarkut, brenda të cilit ushtrojnë kompetencat anëtarët e tij;

.....

ç) kujdeset për ndërgjegjësimin dhe orienton organizimin e fushatave e takimeve ndërgjegjëse kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave, si dhe në publikimin e materialeve ndërgjegjëse dhe informuese;

.....

dh) bën propozime dhe kërkesa konkrete, të cilat u drejtohen autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror e vendor për mënyrën e zgjidhjes së problematikave në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave në përgjithësi.....

Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”

I. Statuti dhe Misioni i Shërbimit Social Shtetëror

Shërbimi Social Shtetëror është institucion buxhetor në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet e ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore, më tej “ministri”, me seli në Tiranë. Shërbimi Social Shtetëror ka si mision zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

II. Përgjegjësitë dhe Funksionet e Shërbimit Social Shtetëror

.....

2. Shërbimi Social Shtetëror, sipas fushave të veprimtarisë, në nivel qendror, ka këto funksione:

3. 3.1 Për ndihmën ekonomike:

.....

g) Asiston njësitë e qeverisjes vendore dhe trajnon nëpunësit e tyre në ofrimin dhe përmirësimin e shërbimeve për ndihmën ekonomike;

IV. ANALIZA LIGJORE.

Shteti shqiptar ka ndërmarrë angazhimin për të mbrojtur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare me miratimin e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cili ndër vite ka pësuar disa ndryshime, ku më i fundit daton në vitin 2020. Me ligjin nr. 104/2012, datë 8.11.2012, është ratifikuar Konventa e Këshillit të

Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit). Në kuadër të mbrojtjes dhe mbështetjes për viktimat e dhunës, Konventa e Stambollit vendos në nenin 20, detyrimin ndaj shteteve për të garantuar që viktimat të kenë akses në shërbime që lehtësojnë rehabilitimin e tyre nga dhuna. Ndër të tjera, këto masa duhet të përfshijnë edhe ofrimin e ndihmës financiare, përpos shërbimeve të tjera si, konsulenca ligjore dhe psikologjike, strehimi, arsimi, trajnimi dhe ndihma në gjetjen e një pune.

Në këtë kontekst, në bazë të ligjit nr. 57/2019, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, janë përfituese të ndihmës ekonomike. Në bazë të ligjit nr.57/2019, subjekte përfituese të ndihmës ekonomike janë familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme dhe disa kategori individësh sipas përcaktimeve të nenit 7, të këtij ligji, ku mes të cilëve sipas gërmës “d”, përfshihen viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare. Sipas nenit 7, të ligjit nr.57/2019, kriteret kryesore për përfitimin e ndihmës ekonomike nga ana e familjeve, është mungesa e të ardhurave ose të ardhura të pamjaftueshme. Për viktimat e dhunës në marrëdhënie familjare përfitimi i ndihmës ekonomike (NE) nuk lidhet dhe nuk kushtëzohet nga të ardhurat, por vetëm me faktin që individ i jetë i pajisur me urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes. Ndihma ekonomike përfitohet gjatë vlefshmërisë së urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) ose urdhrit të mbrojtjes (UM) dhe viktimat e dhunës të mos jetë duke u trajtuar në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Bazuar në kriteret e përcaktuara nga ligji, e drejta e viktimave të dhunës në familje për të përfituar ndihmë ekonomike, në kuadër të asistencës sociale të ofruar nga shteti, kushtëzohet vetëm nga statusi i tyre si viktimë e dhunës në marrëdhënie familjare, pavarësisht nga niveli i të ardhurave apo mundësitë ekonomike, që viktimat e dhunës kanë.

Bazuar në problematikat e adresuara nga QDNJD dhe të gjitha fakteve dhe rrethanave të konstatuara gjatë hetimit administrativ të zhvilluar, Komisioneri konstaton se është e nevojshme që të sqarohen çështjet e mëposhtme:

- **A kanë të drejtë viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të pajisura me UMM të përfitojnë ndihmë ekonomike sipas ligjit nr.57/2019? Nëse po, a e përfitojnë efektivisht NE?**

Bazuar në nenin 7, germa “d”, të ligjit nr.57/2019, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë gjatë periudhës së vlefshmërisë së UMM. Të njëjtën të drejtë të garantuar nga ligji e gjejnë të parashikuar edhe në germen “d”, të pikës 2, të Kreut I, të VKM nr.597/2019, që është një akt nënligjor i cili ka dalë në bazë dhe për zbatim të ligjit të sipërcituar.

Procedura e lëshimit të UMM, parashikohet nga dispozitat e ligjit nr.9669/2006, të ndryshuar. Referuar neneve 19 e 20 të këtij ligji, rezulton se UMM ka një kohëzgjatje më të vogël se 1

muaj, pasi nga momenti i lëshimit të UMM nga gjykata, kjo e fundit, jo më vonë se 20 ditë nga lëshimi i UMM, zhvillon gjykimin për vërtetimin e UMM. Në përfundim të gjykimit për vërtetimin e UMM, gjykata lëshon UM. Por gjykata mund të vendosë edhe anulimin, si dhe ndërprerjen e efekteve të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të lëshuar më parë me vendim gjykatë, kur ky i fundit nuk arrin të provohet ose të refuzojë lëshimin e UM me vendim gjykatë, kur nuk arrin të provohet urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes, i lëshuar më parë me vendim gjykatë.

Referuar dispozitave të ligjit nr. nr.9669/2006, gjykata me kërkesë të palës mund të lëshojë UM, pa lëshuar më parë UMM.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, rezultoi e provuar si nga deklaratimet e përfaqësueses së SHSSH, ashtu edhe nga deklaratimet e përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë dhe Bashkisë Kamëz, se, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare e pajisur me UMM, nuk përfiton ndihmë ekonomike gjatë periudhës së vlefshmërisë së këtij urdhri. Në lidhje me UMM, SHSSH, deklaroi gjatë seancës dëgjimore se, nuk ka përfitime ditore dhe NE sipas ligjit është një pagesë mujore.

Ky qëndrim vjen në kundërshtim edhe me vetë përgjigjen e SHSSH në shkresën nr.2127/1 prot datë 22.11.2021, ku shprehet se, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të cilat rezultojnë të pajisura me UM ose UMM, kanë të drejtën të alikojnë për ndihmë ekonomike.

Bashkia Tiranë dhe Bashkia Kamëz mbajtën të njëjtin qëndrim duke theksuar se nuk ka pagesa në ditë por ka vetëm mujore. Përfaqësuesit e bashkive theksuan se nuk kanë se si ta pasqyrojnë në sistem peridhën e vlefshmërisë së UMM.

Bazuar në parashikimet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë të drejtën për të përfituar NE nga viktimat e dhunës së marrëdhëniet familjare, Komisioneri vlerëson se, praktika e ndjekur në lidhje me mospërfitimin e NE nga viktimat e dhunës të pajisura me UMM, vjen në kundërshtim me parashikimet ligjore.

Komisioneri konstaton se, ligji në mënyrë të qartë, njeh të drejtën viktimave të dhunës në marrëdhëniet familje për të përfituar NE gjatë periudhës që janë të pajisur me UMM. Kjo e drejtë qartësohet më tej edhe nga parashikimi që bëhet në pikën 4.5, të Kreut I, të VKM nr.597/2019, ku përcaktohet se dokumentacioni i nevojshëm për përfitimin e NE, për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, është karta e identitetit, UM ose UMM.

Referuar nenit 12, të ligjit nr.57/2019, parashikohet se, NE është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, çka nënkupton se ajo jepet një herë në muaj, në një pagesë të vetme dhe që nuk mund të copëzohet. Përllogaritja e masës së NE nuk bëhet në bazë të ditëve, por përcaktohet me VKM, dhe konkretisht në VKM nr. 597/2019. Bazuar në VKM e sipërcituar, Kreu III, pika 8, përcaktohet se masa e NE për çdo viktimë të dhunës në

marrëdhëniet familjare, që nuk trajtohet në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të përcaktuar në UM apo UMM, që prej muajit janar 2022, është në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë, nga 3 000 (tre mijë) lekë që ishte më parë. Edhe në pikën e sipërcituar në kësaj VKM, theksohet se NE përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë së UM ose UMM, të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

Në lidhje me justifikimin se, sistemi nuk mundëson teknikisht hedhjen e periudhës së vlefshmërisë së UMM, e cila është një periudhë më e vogël se 1 muaj, Komisioneri e vlerëson gjithashtu të pabazuar, pasi sistemi i NE duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të pasqyrojë kërkesat e parashikuara nga ligji. Sistemi i NE, është një mjet që shërben për zbatimin e ligjit dhe jo e anasjellta. Nëse sistemi i NE nuk pasqyron drejtë dhe saktë parashikimet ligjore atëherë ai është duke cënuar të drejtat e garantuara nga ligji për viktimat e dhunës në familje.

Komisioneri arrin në përfundimin se, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të pajisura me UMM, kanë të drejtën të përfitojnë NE, por në kundërshtim me ligjin, kjo e drejtë nuk garantohet për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

- A kushtëzohet përfitimi i NE për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, nga marrja formë të prerë e vendimit të gjykatës për lëshimin e UM?

Gjykimi dhe vendimi i gjykatës për lëshimin e UM dhe UMM, kanë një natyrë të veçantë dhe rregullohen në mënyrë të posaçme nga ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, i ndryshuar, përpos respektimit të parashikimeve të përgjithshme të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Konkretisht, referuar nenit 19, pika 6, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, të ndryshuar, vendimi i gjykatës për lëshimin e UMM, përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Bazuar në nenin 21, pika 2, të po këtij ligji përcaktohet se, paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e UMM ose UM. Në këtë kontekst edhe parashikimi që bëhet nga ligji nr.57/2019, shkon në të njëjtën linjë me natyrën e vendimit të gjykatës për lëshimin e UM dhe UMM, duke parashikuar përfitimin e NE nga viktimat e dhunës në familje, pa vendosur kushtëzimin që vendimi të ketë marrë formë të prerë.

Si gjatë komunikimit shkresor, ashtu edhe gjatë seancës dëgjimore, nëpërmjet përfaqësuesit në seancë, SHSSH deklaroi se, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare që rezultojnë të pajisura me UM ose UMM, kanë të drejtën të aplikojnë për të përfituar NE, duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar (kartë identiteti dhe UM ose UMM), pa qenë të detyruar për t'u pajisur me një vendim gjyqësor të formës së prerë.

Bazuar në informacionin shkresor të përcjellë nga ana e të dyja bashkive, nga Bashkia Tiranë dhe Bashkia Kamëz, ashtu edhe nga deklaratimet e bëra nga përfaqësuesit e tyre gjatë seancës dëgjimore, qasja dhe praktika që ndiqet nga Bashkia Kamëz dhe Bashkia Tiranë është e

ndryshme. Të dy këto bashki, e kushtëzojnë NE për viktimat e dhunës në familje me marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor për lëshimin e UM ose vërtetimit të UMM.

Bazuar në praktikat e administruara të rasteve të viktimave të dhunës, për të cilat QDNJD, pretendoi se kanë përfituar ndihmën ekonomike vetëm pasi vendimi gjyqësor për lëshimin e UM ka marrë formë të prerë, rezultoi si më poshtë:

1. **Znj. X.X** është banuese në **Njësinë Administrative Nr.4 Bashkia Tiranë**. Është pajisur me UM në datë 19.03.2021, për një periudhë 6 (gjashtë) mujore duke filluar nga data 19.03.2021-19.09.2021. Vendimi për lëshimin e UM ka marrë formë të prerë në datën 10.05.2022. Ka aplikuar në datë 10.05.2021 dhe ka mundur të përfitoj NE për periudhën maj – tetor 2021.
2. **Znj. X.X** është banuese në **Njësinë Administrative Nr.1, Bashkia Tiranë**. Është pajisur me UMM në datën 18.02.2021 dhe në datën 01.03.2021 është lëshuar UM, për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore, duke filluar nga data 01.03.2021-01.03.2022. Vendimi për lëshimin e UM nuk rezulton të jetë ankimuar, por nuk ka informacion kur ka marrë formë të prerë. Nuk ka informacion për datën kur ka aplikuar. Ka mundur të përfitojë NE për periudhën 01.04.2021 e në vazhdim.
3. **Znj. X.X** është banuese në **Njësinë Administrative Nr.3, Bashkia Tiranë**. Është pajisur fillimisht me UMM. Në datë 28.12.2020 është lëshuar UM, për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore duke filluar nga data 28.12.2020-28.12.2021. Vendimi për lëshimin e UM është ankimuar dhe çështja është gjykuar në apel në datën 12.03.2021. Nuk ka informacion për datën kur ka aplikuar. Ka mundur të përfitojë NE për periudhën prill-dhjetor 2021.
4. **Znj. X.X** është banore në **Njësinë Administrative Zall Herr, Bashkia Tiranë**. Është pajisur me UMM në datën 17.10.2020 dhe në datën 03.11.2020, është lëshuar UM për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore, duke filluar nga data 03.11.2020-03.11.2021. Vendimi për lëshimin e UM nuk rezulton të jetë ankimuar, por nuk ka informacion kur ka marrë formë të prerë. Nuk ka informacion për datën kur ka aplikuar. Ka mundur të përfitojë NE për periudhën 01.05.2021 -30.11.2021.
5. **Znj. X.X** është banore në **Njësinë Administrative Zall Herr, Bashkia Tiranë**. Është pajisur me UMM në datën 12.01.2021 dhe në datë 29.01.2021 është lëshuar UM për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) mujore, duke filluar nga data 29.01.2021-28.01.2022. Vendimi për lëshimin e UM ka marrë formë të prerë në datën 17.02.2021. Nuk ka informacion për datën kur ka aplikuar. Ka mundur të përfitojë NE për periudhën 01.03.2021-31.01.2022
6. **Znj. X.X** është banuese në **Njësinë Administrative Paskuqan, Bashkia Kamëz**. Është pajisur me UMM në datën 29.05.2021 dhe në datën 09.06.2021 është lëshuar UM për një periudhë 10 (dhjetë) mujore, duke filluar nga data 09.06.2021-09.04.2022. Vendimi për lëshimin e UM ka marrë formë të prerë në datën 19.07.2021. Ka aplikuar në datën 03.08.2021 dhe më pas ka mundur të përfitojë NE.
7. **Znj. X.X** është banuese në **Bashkinë Kamëz**. Është pajisur me UMM në datën 03.03.2021 dhe në datën 10.03.2021 është lëshuar UM për një periudhë 12 (dydhjetë) mujore, duke filluar nga data 10.03.2021-09.03.2022. Vendimi për lëshimin e UM ka

marrë formë të prerë në datën 21.04.2021. Ka aplikuar në datën 04.05.2021 dhe më pas ka mundur të përfitojë NE.

8. **Znj. X.X** është banuese në **Bashkinë Kamëz**. Është pajisur me UMM në datën 02.03.2021 dhe në datën 07.03.2021 është lëshuar UM për një periudhë 12 (dydhjetë) mujore, duke filluar nga data 07.03.2021-06.03.2022. Vendimi për lëshimin e UM ka marrë formë të prerë në datën 20.04.2021. Ka aplikuar në datën 10.05.2021 dhe më pas ka mundur të përfitojë NE.
9. **Znj. X.X** është banuese në **Bashkinë Kamëz**. Është pajisur me UMM në datën 29.05.2021 dhe në datën 09.06.2021 është lëshuar UM për një periudhë 10 (dhjetë) mujore, duke filluar nga data 09.06.2021-09.04.2022. Vendimi për lëshimin e UM ka marrë formë të prerë në datën 19.07.2021. Ka aplikuar në datën 03.09.2021 dhe më pas ka mundur të përfitojë NE.
10. **Znj. X.X** është banore në **Bashkinë Kamez**. Është pajisur me UMM në datën 09.04.2021 dhe në datë 22.04.2021 është lëshuar UM për një periudhë 8 (tetë) mujore, duke filluar nga data 22.04.2021-21.12.2021. Vendimi për lëshimin e UM ka marrë formë të prerë në datën 24.05.2021. Ka aplikuar në datën 08.06.2021 dhe më pas ka mundur të përfitojë NE.

Bazuar në të dhënat e mësipërme rezulton se, të gjitha rastet viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, kanë mundur të përfitojnë NE vetëm pasi vendimi për lëshimin e UM ka marrë formë të prerë.

Referuar informacionit të vendosur në dispozicion nga Bashkia Tiranë dhe Bashkia Kamëz, të dy këto institucione deklaruan se, merrnin masa për të mbështetur viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare, sapo merrnin dijeni për vendimin e gjykatës për lëshimin e UM ose UMM, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndryshme, ndër të tjera, konsulencë ligjore, mbështetje psiko-sociale, orientim për aplikim në programet e strehimit, punësimit, kurset profesionale, programet arsimore për fëmijët e viktimave të dhunës si dhe mbështetje me ndihmë ekonomike nga fondi lokal për një periudhë të kufizuar kohe. Në këtë kontekst, njësitë e vetëqeverisjes vendore e zbatojnë vendimin e gjykatës për lëshimin e UM dhe UMM edhe kur nuk është i formës së prerë, por kjo gjë nuk ndodh vetëm për sa i përket përfitimit të NE, sipas përcaktimit të germës “d”, të nenit 7, të ligjit nr.57/2019. Këto autoritete, ndryshojnë qasjen e zbatimit të vendimit të gjykatës për lëshimin e UM ose UMM, vetëm për sa i përket përfitimit të NE, duke e kushtëzuar përfitimin e kësaj të fundit me marrjen e vendimit formë të prerë.

Komisioneri konstaton se, ligji nr.57/2019, iu njeh viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare të drejtën për të përfituar NE, që në momentin e pajisjes me vendimin e gjykatës për lëshimin e UM ose UMM dhe përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së UM ose UMM, duke mos e kushtëzuar këtë të drejtë me faktin që vendimi gjyqësor duhet të marrë formë të prerë. Në ato raste kur ligji e kushtëzon përfitimin e NE me ekzistencën e formës së prerë të vendimit gjyqësor, e ka vendosur këtë detyrim në mënyrë të shprehur, sikurse parashikimi që bëhet në nenin 12, pika 7 të ligjit nr.57/2019, ku përcaktohet se : “7.Anëtarit të familjes në

nevojë, që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuan dënimin me heqje lirie ose që trajtohet me mjekim të detyruar me vendim gjykate, në institucionet mjekësore të posaçme, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.”

Në analizë të kuadrit ligjor në fuqi, akteve dhe informacionit të administruar gjatë shqyrtimit të çështjes, Komisioneri arrin në përfundimin se, praktika e ndjekur nga Bashkia Kamëz dhe Bashkia Tiranë, duke kushtëzuar NE për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare me marrjen formë të prerë të vendimit gjyqësor për lëshimin e UM ose vërtetimit të UMM, vjen në kundërshtim me ligjin nr.57/2019, ligjin nr.9669/18.12.2006, i ndryshuar, si dhe me frymën e parimeve të Kushtetutës, Konventave dhe legjislacionit.

- **A mundësojnë procedurat dhe sistemi i ndihmës ekonomike, të drejtën e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare për të përfituar efektivisht të drejtën për të përfituar NE, sipas parashikimit ligjor?**

Bazuar në ligjin nr.57/2019, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare përcaktohen si kategori përfituese të NE. Kjo e drejtë sikurse më sipër është arsyetuar iu lind viktimave të dhunës që në momentin e pajisjes me vendimin gjyqësor për lëshimin e UM ose UMM. Por që kjo e drejtë të bëhet efektive duhet që viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të aplikojnë për të përfituar NE. Pra, efektet financiare fillojnë që nga momenti i aplikimit për ndihmë ekonomike.

Bazuar në pikën 1, të Kreut II, të VKM nr.597/2019, aplikimi për të përfituar ndihmën ekonomike për të gjitha kategoritë, përfshi këtu edhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare bëhet nga data 1-10 të çdo muaji. Pas kësaj date asnjë nga kategoritë përfituese, përfshi këtu viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk mund të aplikojnë për të përfituar ndihmën ekonomike.

Në rastin e viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare, konstatohen disa situata, kur viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk mund të aplikojnë për të përfituar NE, për shkaqe të cilat nuk janë në vullnetin e tyre:

Së pari, viktimat e dhunës në familje pajiset me vendimin gjyqësor për lëshimin e UM, pas datës 10 të muajit. Ato nuk mund të aplikojnë për të përfituar NE për muajin në të cilin është lëshuar UM, pasi sistemi është i mbyllur pas datës 10. (Për rastin e UMM, të cilët lëshohen për një periudhë më pak se 1 muaj, sikurse është konkluduar më sipër, viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk përfitojnë NE, në kundërshtim me parashikimin e ligjit nr.57/2019, i cili njeh këtë të drejtë)

Së dyti, viktimat e dhunës në familje e pajisur me vendim gjyqësor për lëshimin e UM gjatë 10 ditëve të para të muajit, pra kur është i hapur procesi i aplikimit për NE, i duhet të presë që vendimi të marrë formë të prerë, ndërkohë që gjatë kësaj kohe kalojnë afatet e aplikimit.

Së treti, vendimi i gjykatës për lëshimin e UM, mund të ankimohet në gjykatën e apelit dhe viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare i duhet të presë gjykimin e UM në apel.

Së katërti, vendimi gjyqësor për lëshimin e UM, sikurse deklaruan palët pjesmarrëse gjatë seancës dëgjimore, mund të ketë vonesa nga ana e gjykatës dhe viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare, jo për fajin e saj, nuk mund të aplikojë, pasi në momentin e aplikimit i duhet të dorëzojë kopjen e vendimit gjyqësor, i cili mund të ketë vonesa në zbardhje apo në procedura të tjera administrative të gjykatës që kanë të bëjnë me kryerjen e njoftimit.

Gjatë shqyrtimit të çështjes, SH.S.SH, mbajti qëndrimin se, për të gjitha ato rastet kur, UM lëshohet nga gjykata pas datës 10 të çdo muaji, qytetarëve u jepet e drejta për të aplikuar në muajin pasardhës dhe e drejta e përfitimit shtrihet nga muaji i aplikimit përgjatë gjithë vlefshmërisë së UM, pa humbur përfitimin e muajit përkatës në të cilin është lëshuar UM. Por, edhe në këtë rast, konstatohet se, viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare mund të përfitojë vetëm nëse vendimi i gjykatës për lëshimin e UM, merr formë të prerë brenda 10 ditëve të para të muajit pasardhës nga momenti i lëshimit nga gjykata. Në këtë mënyrë mbulohet vetëm pagesa për 1 (një) muaj të prapambetur.

Nëse vendimi i gjykatës ankimohet ose ka vonesa nga ana e gjykatës dhe viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk mund të aplikojë 10 ditët e para të muajit pasardhës nga momenti i lëshimit të UM, atëherë viktima e dhunës nuk mund të përfitojë për muajt paraardhës, për të cilët ajo ka qenë në pamundësi për të aplikuar për shkaqe që nuk janë në vullnetin e saj, pra vonesa në aplikim nuk shkaktohet për faj të viktimës së dhunës në marrëdhëniet familjare.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesit e QDNJD, deklaruan se sipas një studimi të realizuar nga ana e tyre gjatë vitit 2021, rezulton se gjykimi në gjykatën e apelit për rastet kur vendimi i gjykatës për lëshimin e UM ankimohet, zgjasin 2-6 muaj.⁵

Gjithashtu, nga aktet e administruara rezulton se, në një nga rastet e administruara, viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare është pajisur me UM në datën 28.12.2020, ndërsa gjykimi në apel ka përfunduar në datën 02.03.2021. Ajo ka mundur të përfitojë vetëm 9 muaj ndihmë ekonomike ndërkohë që ka qenë e pajisur me UM për një periudhë 12 mujore, që i mundësonte asaj të ishte përfituese e NE përgjatë 12 muajve të vlefshmërisë së UM. Jo për faj të saj, viktima e dhunës në marrëdhëniet familjare nuk ka mundur të përfitojë nga e drejta që ligji i ka njohur asaj.

Nga të dhënat rezulton se, gjatë vitit 2019 janë identifikuar dhe proceduar 4,629 raste të dhunës në familje dhe 4,701 raste në vitin 2020. Në vitin 2019 janë lëshuar 2,834 urdhra mbrojtjeje kundrejt rasteve të raportuara të dhunës në familje dhe 2,816 urdhra mbrojtjeje të

⁵ Studim “Sistemi gjyqësor si pararendës në mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunë me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, Qendra “Për të Drejtat e Njeriut në Demokraci”, viti 2021: <https://www.hrdc.al/index.php/al/sherbime/studime>

lëshuara për periudhën 2020. Ndërsa rezulton se gjatë vitit 2019, numri mesatar i viktimave të dhunës që kanë përfituar NE është 456, ndërsa gjatë vitit 2020 ky numër është 528⁶.

Të dhënat tregojnë se ka një diferencë të konsiderueshme midis viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare që iu ka lindur e drejta për të përfituar NE dhe viktimave të dhunës që kanë përfituar efektivisht nga kjo e drejtë, pra që kanë qenë përfitues të NE të parashikuar për këtë kategori.

NE, është një e drejtë dhe jo një detyrim për viktimat e dhunës dhe rrjedhimisht mund të ketë viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare të cilat nuk aplikojnë për të përfituar NE. Megjithatë brenda kësaj kategorie që nuk aplikon, për shkak të vulnerabilitetit ose mungesës së informacionit që viktimat e dhunës kanë për të drejtat e tyre ligjore, ndodh që mosaplikimi për NE mund të mos jetë një zgjedhje e bërë me vullnetin e tyre, por është pikërisht për shkak të mungesës së informacionit.

Në këtë kontekst, legjislacioni i NE ngarkon administratorët shoqërorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore me detyrën që të identifikojnë familjet dhe individët në nevojë dhe t'i ftojnë e t'i informojnë për aplikim për NE. Nga ana tjetër, ligji nr.9669/2006, vendos detyrimin mbi gjykatat që brenda 24 orëve nga dhënia e vendimit për lëshimin e UM ose UMM të njoftojnë zyrën e shërbimeve sociale të njësive vendore lidhur me vendimin e marrë. Për shkak të vulnerabilitetit që kanë viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare por edhe kategoritë përfituese të NE në përgjithësi, informimi i tyre për të drejtat që i linden nga kuadri ligjor në fuqi, merr një rëndësi të veçantë në mënyrë që ata të përfitojnë efektivisht nga të drejtat e garantuara. Informacioni që iu mundësohet viktimave të dhunës në familje duhet të jetë cilësor dhe jo t'i keqinformojë ato, pasi kjo sjell si pasojë që kjo kategori të cënohet në të drejtat dhe përfitimet që i takojnë.

Komisioneri dëshiron të evidentojë se, objekt i çështjes në shqyrtim, janë situatat dhe rastet kur viktimat e dhunës në familje, jo për fajin e tyre nuk mund të jenë përfitues të ndihmës ekonomike sipas të drejtës që ligji i njeh kësaj kategori, edhe pse mund të ketë persona të cilët me vullnetin e tyre zgjedhin të mos aplikojnë për të përfituar NE. Informacioni dhe dokumentacioni i administruar tregon se në praktikë viktimat e dhunës vendosen në kushte të pafavorshme, të cilat nuk iu mundësojnë që të gëzojnë në mënyrë efektive të drejtën e njohur me ligj.

Përfundimisht dhe bazuar në sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, procedurat dhe sistemi i ndihmës ekonomike, nuk u mundëson viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare për të përfituar NE, në mënyrë efektive dhe sipas përcaktimeve në ligjin nr.57/2019, frymën e Kushtetutës, Konventave të Ratifikuara dhe legjislacionit.

6 Studim “Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale nga familjet dhe individët në nevojë, viktimat e dhunës në familje dhe personat me aftësi të kufizuara”, hartuar nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me mbështetjen e UNDP dhe Austrian Development Cooperation (ADC), viti 2021.

V. PËRFUNDIME

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë”* (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁷. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁸. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme⁹. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹⁰.

Gratë përfaqësojnë numrin më të madh të viktimave të dhunës në marrëdhënie familjare. Në këtë kontekst, gjinia shtohet si një faktor i shtuar risku dhe si një shkak, i cili në ndërveprim me shkaqet e tjera, e vendos viktimën e dhunës në marrëdhëniet familjare në pozita akoma më

⁷ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁸ Shih: Çështja *Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

⁹ Shih: Çështja *J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁰ Shih: Çështjen *Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen *Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; Çështjen *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

të pafavorshme, për shkak të gjinisë. Në këtë mënyrë, gratë në mënyrë disproporcionale mund të preken nga përjashtimi për të aksesuar në mënyrë efektive NE, duke u vendosur në kushte të pafavorshme.

GREVIO në Raportin për Shqipërinë, të vitit 2017, në kuadër të adresimit të diskriminimit ndërsektorial, inkurajon autoritetet që, programet për të parandaluar dhe luftuar dhunën kundër grave, të jenë të përshtatura sipas nevojave specifike të grupeve të ndryshme.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur shteti krijon skema të caktuara të mbrojtjes sociale, duhet që ta sigurojë atë dhe t'i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme. Mbështetja e ofruar për kategorinë e viktimave të dhunës në marrëdhënie familjare, nuk është efektive nëse nuk vlerësohen dhe merren në konsideratë karakteristikat e veçanta kushtet specifike.

Komisioneri arrin në përfundimin se praktika e ndjekur nga Bashkia Tiranë dhe Bashkia Kamëz lidhur me kushtëzimin e NE nga viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, me marrjen e vendimit për lëshimin e UM formë të prerë, e vendos këtë kategori në kushte të pafavorshme. Trajtimi i pafavorshëm brenda kësaj kategori, ka efekte akoma më negative për gratë, të cilat përfaqësojnë numrin më të lartë të viktimave të dhunës në marrëdhënie familjare.

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura dhe sistemi i NE, vijnë në kundërshtim me parashikimet e germës “d”, të nenit 7, të ligjit nr.57/2019 dhe vendos në kushte të pafavorshme viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke mos garantuar në mënyrë efektive të drejtën e parashikuar nga ligji. Komisioneri, nuk është organi kompetent për të ofruar zgjidhjen e kësaj situate, pasi i takon MSHMS, e cila është përgjegjëse për çështjet sociale dhe autoriteti përgjegjës për hartimin e politikave, të programeve dhe legjislacionit, programimin e fondeve për programet e asistencës sociale, si dhe kontrollin e zbatimit të tyre në të gjitha nivelet e strukturave qendrore dhe vendor.

Komisioneri konstaton se, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje, në të dy bashkitë, Bashkinë Kamëz dhe Bashkinë Tiranë edhe pse ka patur dijeni për problematikat të cilat janë diskutuar gjatë mbledhjeve të tij, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për të adresuar këto problematika pranë SHSSH ose MSHMS.

Sa më sipër, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me qëllim rregullimin e situatës së konstatuar dhe bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Komisioneri ka kompetencë:f)..... të bëjë rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin”*,

REKOMANDON

1. Bashkia Tiranë dhe Bashkia Kamëz, të marrin masa të menjëhershme:
 - 1.1 Për të ndaluar praktikën e kushtëzimit të NE për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, me marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes (UM).
 - 1.2 Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në juridiksionin e tyre, të përfitojnë ndihmën ekonomike (NE) që nga momenti që gjykata me vendim, ka lëshuar Urdhrin e Mbrojtjes (UM).
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror, bazuar në kompetencat e tyre ligjore, të marrin masa të menjëhershme, për të udhëzuar dhe asistuar të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim shmangien e praktikës së kushtëzimit të NE për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, me marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes (UM).
3. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa të menjëhershme për të përshtatur procedurat dhe sistemin e ndihmës ekonomike (NE), në mënyrë të tillë që:
 - 3.1 Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të përfitojnë ndihmën ekonomike, sipas parashikimeve të germës “d”, të nenit 7, të ligjit nr.57/2019 “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*”, që në momentin që gjykata merr vendimin për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) dhe gjatë gjithë vlefshmërisë së tij, pavarësisht se kohëzgjatja është më pak se 1 (një) muaj.
 - 3.2 Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të përfitojnë në mënyrë efektive ndihmën ekonomike, sipas parashikimeve të germës “d”, të nenit 7, të ligjit nr.57/2019 “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*” që në momentin që gjykata merr vendimin për lëshimin e urdhrit të mbrojtjes (UM).
4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimi Social Shtetëror, bazuar në kompetencat e tyre ligjore, të marrin masa të menjëhershme, për të udhëzuar të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore/ administratorët shoqërorë, të procedojnë me aplikimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, nëse viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare depoziton shkurtimin e vendimit/dispozitivin e gjykatës që ka vendosur lëshimin e urdhrit të mbrojtjes apo të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, me qëllim shmangien e vonësive në përfitimin e ndihmës ekonomike nga ana e viktimave të dhunës në familje, deri në zbardhjen e plotë të vendimit gjyqësor.

5. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Familje, duhet të jetë më proaktivë në adresimin e problematikave të konstatuara pranë autoriteteve përgjegjëse.
6. Rekomandohet Këshilli i Lartë Gjyqësor, që të udhëzojë gjykatat, që brenda 24 orëve nga shpallja e vendimit për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes (UMM) ose urdhrit të mbrojtjes (UM), viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare të pajiset me shkurtimin e vendimi/dispozitivin e gjykatës, me qëllim shmangien e vonësve deri në zbardhjen e e plotë të vendimit gjyqësor.

Lutemi brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, përcjelljen e informacionit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi apo çdo informacion tjetër që ka rëndësi lidhur me këtë çështje.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

KOMISIONERI

ROBERT GAJDA